



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	02	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-255
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	-28-	Data: Datum: Date:	21.01.2019
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

REFERENCË:	R.V. 2018				
PËR/ZA/TO:	Z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë				
CC:					
NGA/OD/FROM:	Dr. Naim Bardiqi Sekretar i Përgjithshëm				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i vjetor i aktiviteteve për periudhën 03.01.2018 deri 31.12.2018				
Nr. i zyrës:	116	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	15.01.2019
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/ AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar Ministër Z. Uran Ismaili

Të bashkëlidhur gjeni Raportin vjetor të aktiviteteve të Ministrisë së shëndetësisë për periudhën 03.01.2018 deri 31.12.2018



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministra e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*  
*Departamenti për zhvillimi strategjik shëndetësor*

# RAPORT VJETOR

2018

Rruga e Zagrebit nr 69  
10000 Prishtinë  
Tel : +381 48 700 71718  
<http://mshdks.org>

*Version 1.0*

*Prishtinë 2019*



## Shkurtesat

AQP	Autoriteti Qendror i Prokurimit
DZhSSH	Departamenti për zhvillim strategjik shëndetësor
DShSh	Departamenti për shërbime shëndetësore
DIEKP	Departamenti për integrim evropian dhe koordinim të politikave
DKP	Divizioni i komunikimit me publikun
DI	Departamenti ligjor
DI	Divizioni për infrastrukturë
DFShP	Departament për financa dhe shërbime të përgjithshme
DLAISH	Divizioni për licencim dhe akreditim të institucioneve shëndetësore
FSSH	Fondi i sigurimeve shëndetësore
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPSH	Institucionet private shëndetësore
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KE	Komisioni Evropian
KPSh	Kujdesi parësor shëndetësor
KDSh	Kujdesi dytësor shëndetësor
KRPP	Komisioni rregullativ i prokurimit
KDF	Karta e të drejtave të fëmijëve
KTSh	Kujdesi tretësor shëndetësor
KOGJ	Klinika Obstetrike Gjinekologjike
MF	Ministria e Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
MPB	Ministria e Punëve të brendshme
MAP	Ministria e Administratës Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
BQSHS	Bordi qendror për shkollim specialistik
BEVM	Bordi për edukim të vazhdueshëm mjekësor
OE	Operatori ekonomik
OPSh	Odat e profesionistëve shëndetësor
QEVI	Qendra për edukim të vazhdueshëm të infermierisë
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare

SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
SP	Spital i përgjithshëm
SISH	Sistemi i Informimit Shëndetësor
SHNF	Shëndeti i nënës dhe fëmijës
SSSh 2017 -2021	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021

## 1. Përmbledhje ekzekutive


Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2018 është fokusuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021, në Planin vjetor të punës si dhe Planin kombëtar për zbatim të masave të stabilizimit asocimit.

Me qëllim të realizimit të kornizës së planeve strategjike dhe legislative janë miratuar Plani strategjik për rezistencën antimikrobike 2019-2021, Plani strategjik për Imunizim 2019-2021, Plani i integritetit institucional 2019-2021. Është miratuar Ligji nr.06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut, Udhëzimi Administrativ nr.01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e UA nr.05/2017 për shkollim specialistik dhe Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) Nr.02/2018 mbi regjistrimin e multivitaminave, mineraleve, oligomineraleve, substancave herbale dhe preparateve herbale për të cilat nuk nevojitet autorizim marketing.

Në fushën e ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore janë miratuar dhe botuar 8 udhërrëfyes klinik nga lëmia e shëndetit riprodhues dhe sëmundjeve më të shpeshta kronike. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të SSSH 2017-2021 është botuar dhe publikuar Doracaku për monitorim dhe vlerësim të SSSH-së 2017-2021 dhe është prezantuar raporti i parë gjashtë mujor i monitorimit të SSSH-së. Në zbatim të Rregullores 04/2017 është hapur thirrja e parë publike për mbështetje financiare të OJQ-ve dhe janë subvencionuar 31 OJQ në vlerë prej 342,736.34 euro, është realizuar kësti i parë i pagesave (50% e mjeteve). Është bërë adaptimi i hapësirës për Angiograf dhe është sjellur pajisja e Angiografit me pjesët tjera për shërbime të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës., është finalizuar projekti i ndërrimit të dyerve të sallave dhe renovimit të pritores së Emergjencës së vjetër në QKUK.

Janë realizuar aktivitetet në vazhdimësi për promovimin dhe fuqizimin e konceptit të Mjekësisë Familjare dhe në hartimin e politikave për KPSH, përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës përmes programit të vizitave në shtëpi ku janë realizuar 12,914 vizita. Janë furnizuar institucionet e KPSH-së me barna dhe material shpenzues nga LBE sipas planifikimit ku përqindja e furnizimit për vitin 2018 është 71.53%. Është krijuar aplikacioni për sistemin e menaxhimit të stokut farmaceutik. Me qëllim të përmbushjes së agjendës evropiane, është bërë koordinimi me institucionet, departamentet përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me procesin e integritetit evropian.

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2017 nga 27 rekomandime janë zbatuar 16, 6 rekomandime janë në



proces të zbatimit, 3 do të zbatohen sipas afatit ligjor. Janë bartur kompetencat në Odën e mjekëve të Kosovës (OMK) për çështje etike, edukim të vazhdueshëm profesional, licencim dhe rilicencim të profesionistëve shëndetësorë; janë përgatitur aneks kontratat dhe listat për subvencionim të specializantëve - kategoria vullnetar, në zbatim të UA 01/2018 për shkollim specialistik (plotësim i UA 05/2017).

## 2. Progresi me planin e punës - rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

### Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor (DZhSSh)

Janë koordinuar aktivitetet e politikëbërjes me zyrtarët përgjegjës për hartimin e dokumenteve strategjike dhe është kërkuar raportim në lidhje me mbarëvajtjen e procesit. Dokumentet strategjike të planifikuara për vitin 2018, Plani strategjik për imunizim 2019-2021 dhe Plani për Rezistencë antimikrobike 2019-2021 janë nënshkruar nga ana e Ministrit të shëndetësisë. Janë finalizuar Plani strategjik për promovim dhe edukim shëndetësorë dhe Plani për ShNF/ShR.

Janë standardizuar shkresat elektronike, memo shkresat, procesverbalet dhe format e raportimit për përdorim nga të gjithë zyrtarët e MSh-së; janë botuar 8 (tetë) udhërrëfyes klinik, janë trajnuar 33 profesionistë shëndetësorë për metodologjinë e hartimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike, është botuar dhe publikuar në ëeb faqe të MSh-së Doracaku për monitorim dhe vlerësim të SSSH-së 2017-2021, janë përkthyer dhe botuar ekzemplarët edhe në gjuhën angleze dhe serbe, është prezantuar raporti i parë gjashtë mujor i monitorimit dhe vlerësimit të SSSH-së 2017-2021, janë certifikuar 12 profesionistë në trajnimin për trajner në monitorim dhe vlerësim me ekspertin ndërkombëtar. Janë realizuar vizitat e rregullta në terren për mbikqyrjen e realizimit të punëve në Projektet kapitale.

Janë licencuar 405 institucione private shëndetësore jashtëspitalore dhe 9 institucione private shëndetësore spitalore, vlera hyrëse e fletëpagesave ishte 404,550.00 €, janë realizuar vizitat monitoruese në Ish me qëllim të promovimit dhe monitorimit të të drejtave të njeriut, njoftimi me legjislacionin në fuqi si Ligjit për barazi gjinore, Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, promovimi i Udhërrëfyesit të bazuar në gjini, Planit strategjik për persona me aftësi të kufizuara, Strategjisë për komunitetet RAE, bashkëpunimi ndërinstitucional me OIQ. Në zbatim të Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e finacimit publik të OIQ-ve është bërë thirrja e parë publike ku janë paraqitur për mbështetje 75 projekt propozime nga OIQ-të, prej tyre janë mbështetur 31 OIQ me vlerë prej 342,736.34 euro nga gjithsej 400,000.00 euro të planifikuara për mbështetje financiare të OIQ-ve. Është monitoruar linja telefonike dhe janë regjistruar gjithsej 94 ankesa. Është realizuar blerja e pajisjeve mjekësore për përkrahje të komunitetit RAE në vlerë 48,500,00€ nga buxheti i MSh-së, janë bartur kompetencat në Odën e mjekëve të Kosovës (OMK) për çështje etike, edukim të vazhdueshëm profesional, licencim dhe rilicencim të profesionistëve shëndetësorë; janë përgatitur ankes kontratat dhe listat për subvencionim të specializantëve - kategoria vullnetar, në zbatim të UA 01/2018 për shkollim specialistik (plotësim i UA 05/2017); janë përgatitur kopjet e dosjeve për bartje në OISh-të respektive sipas kërkesave të tyre, janë finalizuar proceset e EVM.

Janë pranuar njëqind e dyzet e shtatë (147) kërkesa për provim të Licencës. Janë mbajtur nëntëmbëdhjetë (19) takime të Komisionit për provim profesional dhe licencim të ergoterapisë, Logopedisë dhe psikologjisë klinike. Provimit i janë nënshtruar pesëmbëdhjetë (15) ergoterapeut, tridhjet e pesë (35) logoped dhe njëzet e nëntë (29) psikolog klinik dhe të gjithë



kanë kaluar me sukses, janë lëshuar gjithsej shtatëdhjetë e nëntë (79) certifikata të provimit të licencës.

Janë lëshuar katërqind e tetë (408) vërtetime mbi stazhin e mbajtur pas-diplomik ( për çështje punsimi/studimi jasht vendit), nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë (996) librezat stazhi për praktikë profesionale pasdiplomike dhe planprograme për stazh themelor profesional. Janë finalizuar treqind e pesëdhjetë e tetë (358) ri-licenca të mjekëve/specialistëve. Është realizuar barazimi i të hyrave të zyrës së licencimit të profesionistëve shëndetësorë me raportet bankare për muajt janar-nëntor 2018.

Totali i të hyrave për muajt janar-nëntor është 61.389,00 € ndërsa për muajin dhjetor raportet bankare i marrim pas përfundimit të vitit.

Janë përgatitur 297 aneks kontrata për mbështetje financiare me subvencionim për kategorinë e specialistëve vullnetar. Janë shqyrtuar 683 aplikacione, 1040 certifikata specialistike, 320 vendime për dalje në provim specialistik, 43 ankesa nga komisioni i ankesave, është realizuar pagesa e specialistëve me subvencion në vlerë prej 663.732,18 euro. Janë regjistruar 517 vullunter dhe përgatitur 298 aneks kontrata. Janë nënshkruar 50 certifikata për shoqatën e nefrologëve, 1000 certifikata të telemjekësisë dhe 340 certifikata të QKMF-Podujevë të akredituara nga BEVM. Janë organizuar provimet e licencës dhe janë lëshuar 1040 certifikata për: 494 infermier, 250 mjekë, 114 stomatolog, 95 farmacist, 114 fizioterapeut, 21 bachelor të radiologjisë, 58 bachelor laborant. Gjithsej 107 vendime të përkohshme për qytetar jo-kosovar, 41 vendime për nostifikim, janë lëshuar 83 licenca për doktorë të mjekësisë, 61 licenca për specialistë të lëmive të ndryshme. Është realizuar barazimi i të hyrave të zyrës së licencimit të profesionistëve shëndetësorë me raportet bankare për muajt janar-shtator 2018 - totali i të hyrave është 47.593,00 euro.

### **Departamenti për shërbime shëndetësore (DShSh)**

Është aprovuar koncepti i dokumentit për revidimin e ligjit të Shëndetit riprodhues dhe FAM, është përgatitur drafti i Planit strategjik për shëndetin e nënës dhe fëmijut dhe shëndetin riprodhues 2019-2021, është përgatitur drafti i Udhëzimit administrativ 'Veprimtaria, struktura dhe funksionet e Shërbimeve Shëndetësore për HIV/AIDS', është finalizuar UA "Obligimet e personit përgjegjës për transplantimin e indeve dhe qelizave", është përgatitur drafti i konceptit të dokumentit 'Sëmundjet e rralla', është përgatitur drafti i programit për skринingun e kancerit të qafës së mitrës, monitorimi i Ligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, është finalizuar materiali për MISP-manualin për trajner-bashkëpunim me KKK dhe janë trajnuar mbi 200 profesionistë shëndetësorë për MISP në 10 komuna, janë shtypur 28.000 fletore për shëndetin e fëmijës, furnizimi me barna/donacione i ShSKUK nga Projekti Hope, është aprovuar preliminar Projekti i Perinatologjisë Kosovare (PeriKos) nga Projekti Hope - Gjermani, finalizimi i tabelave të buxhetit për vitin 2018 dhe 2019, përgatitja e amandamenteve të Projektit ligjit për buxhetin për vitin 2019, National Health Accounts - sistemimi i grupit të punës, procedurave standarde të operimit - përgatitja e stafit dhe futja e 80% të të dhënave në sistem. Janë trajnuar 2.039 punëtorë shëndetësorë, 65 infermierë në KPSH. Janë sistemuar infermierë dhe mami Bachelor në stazhin obligativ pas diplomimit, 417 kandidatë, janë

përgatitur 33 vërtetime për realizim të planprogramit të stazhit pas diplomimit. Janë trajnuar 126 punëtorë shëndetësor (infermier dhe mjekë familjar) në programin për vizitat në shtëpi "Mbështetja e familjeve me qëllim të përmirësimit të shëndetit, zhvillimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. Janë mbajtur trajnimet për profesionistët shëndetësorë të QKMF: Viti, Kamenicë, Gjilan, Lipjan, Shtime, Obiliq, Ferizaj, Hani Elezit, Kaçanik, Vushtrri, Drenas dhe Skenderaj. Mbatja e trajnimit për ToT për vizitat në shtëpi ku janë trajnuar 25 infermier, trajnimi për TOT i 12 profesionistëve shëndetësorë për menaxhimin e pacientëve me TB në KPSH, në KDSH janë trajnuar 249 infermierë, prej tyre: në Spitalin e Ferizajt kanë përfunduar kursin e rregullt gjatë muajve sipas planprogramit të QEVI-t, 18 infermiere; në Spitalin e Pejës 16, në Spitalin e Mitrovicës 50 dhe në Spitalin e Prizrenit 165 profesionist shëndetësor, me planprograme të QEVI-t të akredituar nga OIK-u për vitin 2018.

### **Divizioni për KPSH (DKPSH)**

Ka përfunduar planprogrami për specializantë të mjekësisë familjare për 50 kandidatë të cilët i janë nënshtruar provimit specialistik, 46 kandidatë kanë përfunduar provimin specialistik. Janë realizuar 12,914 vizita në shtëpi për kujdes ndaj nënës dhe fëmijut në pesëmbëdhjetë komuna, janë trajnuar 170 profesionistë shëndetësorë në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës si dhe janë trajnuar 20 trajnerë për ngritjen e kapaciteteve në Institucionet e KPSH me qëllim të zgjerimit të vizitave në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Janë shpërndarë pajisjet bazike (15 artikuj bazik) për KPSH të ofruar nga projekti 'Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor' nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në më shumë se 80 qendra të KPSH-së në 12 komuna që mbështeten nga projekti (Fushë Kosovë, Gjakovë, Glllogoc, Graçanicë, Junik, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë, Obiliq, Rahovec, Skenderaj dhe Vushtrri).

### **Divizioni i farmacisë (DF)**

Përqindja e arritur e furnizimit me barna dhe material shpenzues për vitin 2018 është 71.53%. Në kuadër marrëveshjeve me UNICEF dhe CDF janë zotuar mjetet për vaksina të rregullta dhe terapinë ARV për vitin 2019 sipas para llogarisë së përcjellur me vlerë 500.000€. Janë zotuar gjithë mjetet por në mungesë të liferimeve të shumta rrezikohen të mbeten mjete kjo dhe për shkak të inicimeve me vlera më të ulta krahas çmimeve paraprake. Mjete të angazhuara 7,820.497.00€, obligime në pritje 727,372.00 €, buxheti në free balance 0,00.

### **Departamenti i sistemit të informimit shëndetësor (DSISh)**

Është realizuar blerja e pajisjeve për migrimin e a Legacy Sistemeve në infrastrukture të re: dy (2) Dell Server, 1 VNX 5400 Storage dhe 2 SAN Sëitch-a. Është bërë vendosja e tyre në Data Center në MAP/ASHI. Janë konfiguruar dhe instaluar sistemet operative dhe vendosja e licensave të VMëare, janë krijuar hapsirat për ruajtjen e të dhënave të njohura si (LUNs) me kapacitete nga 2TB dhe 3TB, pastaj janë krijuar serverët virtual të cilët do të zëvendësojnë MShDBS-së dhe MShShIS.

Zhvillimi i Modullit për Departamentin Ligjor, mbështetje teknike për shfrytëzuesit e AVICENNA-së, monitorimi dhe administrimi i infrastrukturës virtuale në baza ditore, përditësimi i VmWare tools nëpër Servera, krijimi i llogarive për shfrytëzuesit e rinj të SESSh-it, gjenerimi i raportit për vizitat në SESSh për komunitetet Ashkali, Rom dhe Egjiptjan dhe gjenerimi i raportit për profesionistët shëndetësor specialist që punojnë në Institucionet Shëndetësore, instalimi i sistemit operativ virtual në sishshp-app, instalimi i prerekuizitave në sishshp-dc.

### **Departamenti për integritet evropian dhe koordinim të politikave (DIEKP)**

Është hartuar raporti për zbatimin e konkluzioneve në kuadër të nën-komiteve të MSA, është përgatitur raporti për takimin me nën-komitefin e MSA për Ekonomi, është hartuar dhe është vendosur në platformën online raporti vjetor 2017(1 janar -31 dhjetor) mbi zbatimin e programit kombëtar për zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2017-2021, është raportuar zbatimi i PKZMSA për tremujorin e parë K1, K2, K3 dhe K4 për vitin 2018, është bërë rishikimi i draftit të PKZMSA për 2019, është përgatitur PKZMSA për vitin 2019; është përgatitur inputi i 2019 periudha (1 shkurt-31 tetor) 2018 për raportin e KE për Kosovën dhe përditësimi për kapitujt 1,2,3 dhe 28, është hartuar drafti i PVPQ 2019, është adaptuar PVPQ sipas rekomandimeve të SKQ, është adaptuar PVPQ sipas Programit dhe Planit legjislativ 2019. Raportimi në Zyrën e BE për të arriturat e sektorit të shëndetësisë në vitin 2018 si kontribut për hartimin e raportit për Kosovën dhe raportimi para Komisionit Evropian për aktivitetet e ministrisë në kuadër të Programit për Reforma Ekonomike. Përgatitja e Listës së dokumenteve strategjike 2018 për Zyrën e Planifikimit Strategjik të Qeverisë, përgatitja e listës së koncept dokumenteve për vitin 2018 për Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, është miratuar Plani për Integritet Institucional 2018-2020.

### **Departamenti ligjor (DL)**

Departamenti Ligjor në kuadër të objektivave kryesore ka realizimin e Programit legjislativ qeveritar 2018 si dhe Planit legjislativ për akte nënligjore për vitin 2018 nga fushëveprimi i Ministrisë së Shëndetësisë. Përmes monitorimit për çdo fillim muaji gjatë vitit 2018 ka mbajtur takime me Zyrtarët përgjegjës për hartimin e akteve ligjore, nënligjore dhe koncept dokumenteve. Procesi ka rezultuar në finalizimin e shumicës së akteve ligjore dhe nënligjore nga Zyrtarët përgjegjës. Është miratuar Ligji nr.06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut, Udhëzimi Administrativ nr.01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e UA nr.05/2017 për shkollim specialistik dhe Udhëzimit Administrativ (në Shëndetësi) Nr.02/2018 mbi regjistrimin e multivitaminave, mineraleve, oligomineraleve, substancave herbale dhe preparateve herbale për të cilat nuk nevojitet autorizim marketing. Gjatë vitit 2018 ka regjistruar të gjitha lëndët e kontesteve gjyqësore/detyrimet kontigjente për vitin 2018. Në sistem janë të regjistruar 41 lëndë. Vlera e detyrimeve kontigjente është 262,876.15 € ku MSh paraqitet si kreditore në vlerën prej 19,140.48 €. MSh është njoftuar me Aktgjykimet nga Gjykatat themelore dhe Gjykata e Apelit, që për katër (4) lëndë të kontestit gjyqësor është në favor të MSh-së.

## **Departamenti i financave dhe shërbimeve të përgjithshme (DFShP)**

Përcjellja dhe menaxhimi i vijueshmërisë në punë, angazhimi në dhënia e këshillave profesionale për stafin e MSh-së dhe institucionet tjera në kuadër të MSh-së, regjistrimi i pushimeve vjetore, mjekësore për nënpunësit civil të MSh-së, pranimi i kërkesave, shqyrtimi i tyre, dërgimi në adresat e caktuara për aprovime dhe përcjellja në procedurë të mëtejme.

Është bërë rishikimi i dosjeve dhe rifreskimi i tyre duke u bazuar në rregulloret në fuqi, është bërë skanimi, rishikimi dhe regjistrimi në mënyrë elektronike i formularëve të vlerësimit të 91 zyrtarëve të MSh-së, si dhe evidentimi i raporteve të vitit 2017 dhe plani i punës për vitin 2018, kanë përfunduar procedurat për funksionalizimin e vijimit elektronik në punë, është inicuar dhe ka përfunduar procedurat për pajisje me ID kartela për të gjithë nëpunësit e MSh. Zhvillimi i të gjitha procedurave të rekrutimit për pozitat e shpallura, janë regjistruar 9667 dokumente në zyrën e arkivit, janë përkthyer gjithsej 229 faqe - gjuhë angleze, 566 faqe - gjuhë serbe. Mbjellja e pishave në parkun e MSh-së, janë mbjell gjithsej 60 copë pisha, Ministrinë e Shëndetësisë gjatë vitit 2018 e kanë vizituar 11601 vizitor, janë hapur 204 shfrytëzues/zyrtar në domain-in GOV. Janë rregulluar 141 kompjuter, janë bërë riparime dhe janë freskuar.

## **Divizioni i komunikimit me publikun (DKP)**

Janë realizuar pesëdhjetë e gjashtë (56) komunikata për media, janë përgatitur tridhjetë e gjashtë (36) ftesa për media, nëntëdhjetë e gjashtë (96) publikime dhe njoftime në ueb-faqe të MSh-së, mbi njëqind e pesëdhjetë (150) procesverbale të takimeve të rregullta të Sekretarit me drejtorët e MSh-së, si dhe takimeve me institucionet vartëse, janë bërë rreth 120 monitorime ditore të mediave on-line, janë shpërndarë 300 regjistra të barnave, janë shqyrtuar (36) kërkesa për Qasje në dokumente publike, janë bërë 3 shkresa (2 përgjigje dhe 1 informatë) për Institucionin e Avokatit të Popullit, janë përzgjedhur 3 sete për projektin "Open Data" Kosova (MAP-ASHI) dhe është bërë inventarizimi i të dhënëve fillestare për rreth 30 sete të dhënash nga shëndetësia, janë shënuar ditët ndërkombëtare në shëndetësi. Pjesëmarrja e rregullt në rreth 30 takime të KFAM-it (Komisionit për Fertilizim të Asistuar Mjekësor) ku janë shqyrtuar rreth 80 lëndë dhe një vizitë "ad-hoc" në një spital privat.

## **Divizioni i prokurimit (DP)**

Janë tenderuar 127 aktivitete të prokurimit (tender), janë nxjerrë 1550 urdhërblerja nga Freebalansi për barna dhe pagesa të ndryshme, janë nënshkruar gjithsej 157 kontrata për barna, material shpenzues medicinal nga LE, projekte kapitale, mallra dhe shërbime të ndryshme për njësitë buxhetore, pjesëmarrja në seanca të OShP-së në mbrojtje të lëndëve të MSh-së para panelit shqyrtues dhe nga OShP janë dhënë 24 vendime, sistemimi i lëndëve dhe arkivimi i dokumenteve, ofrimi i dokumentacionit dhe sqarimet e kërkuara Auditorit të përgjithshëm, ofrimi i dokumentacionit dhe sqarimet e kërkuara nga OJQ dhe organeve tjera që kanë kërkuar qasje në dokumentacionet zyrtare

## **Zyra për barazi gjinore**

Realizimi i vizitave monitoruese në ISHP të kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor në lidhje me njoftimin me lesilacionin në fuqi, ligji për barazi gjinore, ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe procedura standard e veprimit, raste të dhunës në familje janë regjistruar 230 raste që kanë marr shërbime shëndetësore dhe janë plotësuar formularët e veçantë për këtë kategori. Janë trajnuar 145 profesionistë shëndetësore në regjionin e Prishtinës, Gjilanit dhe Mitrovicës (Qendrës Kryesore Mjekësisë Familjare) në regjionin e Prishtinës, Spitalet regjionale dhe Qendrat e Shëndetit Mendor për Procedura Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, Udhërrefyesin mbi dhunën e Bazuar ne Gjini për Ofruesit e shërbimeve shëndetësore.

### 3. Pasqyra e performancës financiare

Tab. 1: Shpenzimet buxhetore në vitin 2018 /206/Ministria e Shëndetësisë

Modaliteti	Buxheti	%
Buxheti i Aprovuar	61,322,576.30	100
Të alokuara	60,977,271.44	99.44
Të shpenzuara	50,458,313.83	82.28
Mjetet e Zotuara / Obligimet	9,735,414.78	15.88
Mjetet e lira	783,542.83	1.28



<b>Tab. 2: Projektet kapitale</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	4,952,192.39	100
Të shpenzuara	3,096,228.76	63
Mjetet e Zotuara / Obligimet	1,745,100.30	35
Mjetet e lira	110,863.33	2
<b>Tab. 3 : 11306 Administrata qendrore e MSh-së</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	1,040,664.37	100
Të shpenzuara	960,023.66	92.25
Mjetet e Zotuara / Obligimet	67,013.30	6.43
Mjetet e lira	13,627.41	1.32
<b>Tab. 4 :11406/ Zyra e Ministrit</b>		

Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	346,836.79	100
Të shpenzuara	317,411.70	92
Mjetet e Zotuara / Obligimet	18,609.70	5
Mjetet e lira	10,815.39	3
<b>Tab 5: 71000/Mbështetjet e Shërbimeve të Mjekësisë familjare</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	904,123.04	100
Të shpenzuara	622,014.48	69
Mjetet e Zotuara / Obligimet	212,625.74	23
Mjetet e lira	69,482.82	8
<b>Tab. 6: Projektet kapitale 71000/Mbështetjet e shërbimeve të mjekësisë familjare</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	840,303.98	100
Të shpenzuara	566,256.04	68
Mjetet e Zotuara / Obligimet	212,625.70	25
Mjetet e lira	61,422.24	7
<b>Tab. 7: 71100/Programi i Shëndetit Publik</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	3,203,051.45	100
Të shpenzuara	2,951,929.77	92
Mjetet e Zotuara / Obligimet	213,352.24	7
Mjetet e lira	37,769.44	1
<b>Tab. 8 Projektet Kapitale 71100/Programet e Shëndetit Publik</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	355,294.00	100
Të shpenzuara	255,500.57	72
Mjetet e Zotuara / Obligimet	98,982.73	28
Mjetet e lira	810.70	0
<b>Tab. 9: 71300/Shërbime përkatëse farmaceutike</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	7,820,497.00	100
Të shpenzuara	6,330,471.94	80.947182
Mjetet e Zotuara / Obligimet	1,490,025.06	19.052818
Mjetet e lira	0.00	0
<b>Tab. 10: 71600 TMJISHP</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	8,900,000.00	100
Të shpenzuara	8,519,450.94	96
Mjetet e Zotuara / Obligimet	175,425.00	2
Mjetet e lira	205,124.06	2


<b>Tab. 11: 71700 Shërbimi Profesional i Transfuzionit të gjakut</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	2,111,835.82	100
Të shpenzuara	2,090,218.03	99
Mjetet e Zotuara / Obligimet	10,401.11	0.5
Mjetet e lira	11,216.68	0.5
<b>Tab. 12: Projektet kapitale 71700 Shërbimi profesional i transfuzionit të gjakut</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	201,476.00	100
Të shpenzuara	197,605.82	99
Mjetet e Zotuara / Obligimet	2,511.54	1
Mjetet e lira	1,358.64	0
<b>Tab. 13: 71900 Administrata e AFSh</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	27,539,345.92	100
Të shpenzuara	21,860,535.59	79
Mjetet e Zotuara / Obligimet	5,654,107.23	20
Mjetet e lira	24,703.10	1
<b>Tab. 14: Projektet kapitale 71900 Administrata AFSh</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	1,486,245.96	100
Të shpenzuara	1,468,545.11	99
Mjetet e Zotuara / Obligimet	16,661.16	1
Mjetet e lira	1,039.69	0
<b>Tab. 15: 72000 Rregullimi i Sektorit Farmaceutik</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	1,168,125.21	100
Të shpenzuara	882,503.66	76
Mjetet e Zotuara / Obligimet	120,046.57	10
Mjetet e lira	165,574.98	14
<b>Tab. 16: Projektet kapitale 72000 - Rregullimi i Sektorit Farmaceutik</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	23,797.50	100
Të shpenzuara	5,150.93	22
Mjetet e Zotuara / Obligimet	0.00	0
Mjetet e lira	18,646.57	78
<b>Tab. 17: 72100 Sistemi i Informimit Shëndetësor</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	2,439,143.10	100
Të shpenzuara	821,119.65	34
Mjetet e Zotuara / Obligimet	1,492,913.02	61



Mjetet e lira	125,110.43	5
<b>Tab. 18: Projektet kapitale 72100 - Sistemi i Informimit Shëndetësor</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	1,995,074.95	100
Të shpenzuara	586,497.76	30
Mjetet e Zotuara / Obligimet	1,380,991.66	69
Mjetet e Lira	27,585.53	1
<b>Tab. 19: 72400 Shërbimi i Inspektoratit</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	260,970.74	100
Të shpenzuara	236,561.26	91
Mjetet e Zotuara / Obligimet	15,096.00	6
Mjetet e Lira	9,313.48	3
<b>Tab. 20: Projekte kapitale 72 400 Shërbimi i inspektoratit</b>		
Të alokuara	0.00	
<b>Tab. 21: 2600 Shërbimi shëndetësor i burgjeve</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	1,236,860.88	100
Të shpenzuara	1,166,420.10	94
Mjetet e Zotuara / Obligimet	69,768.60	6
Mjetet e Lira	672.18	0
<b>Tab. 22: Projekte kapitale 72600 - Shërbimi shëndetësor i burgjeve</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	50,000.00	100
Të shpenzuara	16,672.53	33.34506
Mjetet e Zotuara / Obligimet	33,327	66.65494
Mjetet e Lira	0.00	0
<b>Tab. 23: 78800 Programet stimuluese të performancës</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	212,960.00	100
Të shpenzuara	157,080.83	74
Mjetet e Zotuara / Obligimet	5,848.50	3
Mjetet e Lira	50,030.67	23
<b>Tab. 24: 903 Aftësimi Specialistik dhe EVM</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	3,792,857.12	100
Të shpenzuara	3,542,577.22	93
Mjetet e Zotuara / Obligimet	190,182.71	5
Mjetet e lira	60,097.19	2
<b>Tab. 25: Financimet nga huamarrjet</b>		
Modaliteti	Buxheti	%

Të alokuara	1,100,000.00	100
Të shpenzuara	901,799.74	82
Mjetet e Zotuara / Obligimet	159,119.88	14
Mjetet e Lira	39,080.38	4
<b>Tab. 26: Projekte kapitale 04 - Financimet nga huamarrjet</b>		
Modaliteti	Buxheti	%
Të alokuara	952,092.30	100
Të shpenzuara	848,608.96	89
Mjetet e zotuar / Obligimet	102,708.00	11
Mjetet e lira	775.34	0

**Graf.2: Distribrimi i modaliteteve të Buxhetit të Huamarrja**



**Graf.3: Distribrimi i modaliteteve të Buxhetit të Huamarrja**



Obligimet deri me 30.11.2018 për organizatën buxhetore Ministria e shëndetësisë

Tab: 27

Nr	Programi Buxhetor	Kategoria ekonomike	Vlera	Totali
1	Fondi i sigurimeve shëndetësore	Subvencione	8 913 031.20 €	8 913 031.20 €
2	AKPM	Mallra dhe shërbime	19 264.79 €	19 264.79 €
3	Fondi i sigurimeve shëndetësore	Mallra dhe shërbime	1 197.80 €	1 197.20 €
4	Inspektorati Shëndetësor	Mallra dhe shërbime	100.00 €	100.00 €
<b>Totali</b>			<b>593.79 €</b>	<b>8 933</b>

**Inkasimi i të hyrave vetanake për vitin 2018 deri me datën 18.12.2018**

Në tabelë do të paraqiten të hyrat e inkasuara deri me datë 19.12.2018 për organizatën buxhetore Ministria e Shëndetësisë.

Tab: 28 Inkasimi i të hyrave vetanake për MSh deri me 19.12.2018

Nr	Programi Buxhetor	Vlera e mjeteve
1	113 Administrata Qendrore	432 450.00 €
2	711 IKShPK	719 490.00 €
3	717 QKTGJ	203 917.00 €
4	AKPPM	2 620 359.94 €
5	724 Inspektorati shëndetësor dhe farmaceutik	167 196.00 €
6	903 Aftësimi specialistik dhe EVM	118 313.00 €
<b>TOTALI</b>		<b>4 261 725.94 €</b>

**Divizioni i financave dhe shërbimeve të përgjithshme (DFShP)**

Janë pranuar, nënshkruar dhe proceduar 51 kërkesa për Petty Cash kodi 114, 74 kërkesa për Petty Cash kodi 113, 243 kërkesa për zotim nga kodi 114, 366 kërkesa për zotim nga kodi 113, 184 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 114, 299 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 113, 251 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 713, 130 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 721, 64 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 724, 51 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 726, janë pranuar, 83 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 903, 13 kërkesa për pagesa/blerje nga kodi 710, përgatitja e 568 CPO-ve për kodin 113, 187 CPO-ve për kodin 114, 217 CPO-ve për kodin 721. Janë pranuar 811 fatura dhe janë përcjell për procedim të mëtutjeshëm te njësitë përkatëse në MSh-së, gjithsej 276 kërkesa nga sektorët e MSh-së dhe kabineti i ministrit për furnizim me material shpenzues për zyrë.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 janë pranuar 569 lëndë dhe janë dorëzuar për procedura të mëtutjeshme për pagesë. Janë regjistruar në sistemin e E-pasurisë këto lëndë:

Ndërtimi i QKMF-së Gjilan	NNP ARIAN CO	39,563.98 €
Ndërtimi i QKMF-së Gjakovë	EUROING NPN	120,158.20 €
Ndërtimi i QKMF-së Gjakovë	EUROING NPN	19,824.00 €
Furnizim me pajisje të IT-së (FSSH)	ILIR KOSOVA SHPK	2,365.20 €
Furnizim me pajisje të IT-së (FSSH)	ILIR KOSOVA SHPK	22,872.40 €
Llap top	PROINFO ICT SHPK	933.30 €
Mjete për projektin e angiografit	CONSTRUMAX NNP	40,831.15 €
Punime në projektin	CONSTRUMAX NNP	26,668.09 €
Mbikëqyrja e punimeve	SIB BKA ING SHPK	1,740.17 €
Ndërtimi i QKMF-së Gjakovë	EUROING NPN	115,353.96 €
Mjete për projektin e angiografit	NNP CONSTRUMAX	55,842.99 €
Mjete për projektin e angiografit	NNP CONSTRUMAX	55,807.60 €
Renovimi dhe rivitalizimi i objektit të Kirurgjisë Gjakovë	NNP CONSTRUMAX	55,555.50 €
Ndërtimi i aneksit të urgjencës dhe renovimi (QKMF-se Deçan)	HARST GROUP	44,248.38 €
Renovimi dhe Rivitalizimi i objektit të Kirurgjisë-Gjakovë	CONSTRUMAXX NNP	71,752.07 €
Ndërrimi i dyerve të sallave dhe renovimi i pritores së emergjencës QKUK	GLOBAL-ing	51,438.90 €
Adaptimi i hapësirave për angiograf QKUK	CONSTRUMAXX NNP	19,413.82 €
Pajisje të IT-së	TECHCOM SHPK	9,796.00 €
Pajisje të IT-së (DShB)	TECHCOM SHPK	7,266.00 €
Pajisje të IT-së (ISh)	TECHCOM ShPK	4,290.00 €
Shpenzimet e karburantit për vetura zyrtare Janar-Tetor 2018:		
Kabineti i Ministrit		18,029.04 €;
Administrata e MSh-së		9,510.31€;
Ins. Shën&Farmaceutik		6,211.21 €;
D. Burgjeve		2,734.46 €;
<b>Total</b>		<b>36,185.10 €.</b>

#### 4. Shpenzimet kapitale dhe projektet

##### Vazhdimi i Ndërtimi i Klinikës së re të Emergjencës në QKUK

Shuma e kontratës: 8,106,238.65 €, deri me 30.11.2018, janë shpenzuar: 4,246,039.53 € (as një pagesë në vitin 2018, deri më tani), dinamika shumë e dobët e punimeve, në vitin 2018 nuk ka pasuar as një pagesë, kollaodimi ka gjetur gabime në kalkulim të sasive deri te situacioni 8, ku mbipagesa prej 278,742.99 € duhet të minusohet në situacionet në vazhdim, për barazim, raporti i Kollaodimit është pranuar nga punëkryesi, punimet janë në rrjedhë e siper, në muajt e fundit me një dinamike më të mirë.

<b>Shuma e Kontraktuar:</b>			<b>8,106,238.65 €</b>
Situacioni 1		977,758.79 €	2016
Situacioni 2		647,874.61 €	2016
Situacioni 3	06.03.2017	562,129.30 €	2017
Situacioni 4	10.05.2017	437,700.00 €	2017
Situacioni 5	28.06.2017	388,984.32 €	2017
Situacioni 6	04.10.2017	568,752.07 €	2017
Situacioni 7	21.12.2017	337,725.73 €	2017
Situacioni 8	26.12.2017	325,114.71 €	2017
<b>Akumulimi</b>		<b>4,246,039.53 €</b>	
Punimet e Kontraktuara dhe te realizuara ne “%” sipas pagesave deri me 31.12.2017		<b>52.3% (bazuar ne pagesa)</b>	
Nuk ka pasuar pagesa ne vitin 2018, parashihet vetem nje situacion (9) në funksion të barazimit:			

##### Pagesat e realizuara:

Përqindja e realizuar nxjerrë nga pagesat e punimeve të realizuara është 52.9%.

Punimet.:	Data e kalimit nga DI,	Shuma e paguar (€)	Pagesa e realizuar (viti)
Rruga për qasje & Dislokimi i kablllove	21.12.2016	63,436.13	2016
Punimet shitesë - Aneksi 2	27.11.2017	137,358.62	2017
<b>Punimet shitesë</b>			
<b>Akumulimi</b>		<b>200,794.65 €</b>	Total të paguara shitesë

Rikapitullimi i pagesave deri me 30/09/2018 - punimet:

<b>Punimet e Kontraktuara:</b>	4,246,039.53 €	
<b>Punimet shitesë:</b>	200,794.65 €	
<b>Akumulimi</b>	<b>4,446,834.18 €</b>	Total i pagesave deri me: 31.12.2017

Nuk kishte asnjë pagesë deri me 26.12.2018, projekti është në kontinuitet.

**Ndërtimi i QKMF në Gjilan - MONITORIMI sipas vendimit nr. 05-8618, dt. 22.12.2016:**  
Projekti menaxhohet nga KK Gjilan, shuma e kontratës: 1,195,438.67 €, projekti financohet nga MSH (85%) dhe KK Gjilan (15%), deri me sot, KK Gjilan, ka realizuar një pagesë nga obligimet sipas MM (shiko tabelën), deri me 24.12.2018, janë shfrytëzuar: 542,722.21 €, të mjeteve të parashikuara, janë realizuar: 45.3% të punimeve (%-ndaj sipas pagesave). Në rreth 1.5 muajt e fundit, punëkryesi pothuajse nuk ka punuar fare.

**Pagesat e realizuara:**

<b>Shuma e Kontraktuar:</b>	1,195,438.67 €				
Situacioni 1	05.04.2017	29,289.20 €	Msh	2017	215,913.92 €
Situacioni 2	01.08.2017	117,631.74 €	Msh	2017	
Situacioni 3	27.11.2017	39,563.98 €	Msh	2017	
Situacioni 4	26.12.2017	30,429.00 €	Msh	2017	
Situacioni 5	26.03.2018	39,453.28 €	Msh	2018	150,643.19 €
Situacioni 6	03.05.2018	34,197.35 €	Msh	2018	
Situacioni 7	28.05.2018	44,161.39 €	Msh	2018	
Situacioni 8	07.06.2018	32,831.17 €	Msh	2018	
Situacioni 9	17.07.2018	59,568.59 €	KK Gjilan	2018	59,568.59 €
Situacioni 10	27.08.2018	43,682.64 €	Msh	2018	
Situacioni 11		30,000.00 €	KK Gjilan	2018	
Situacioni 12	17.12.2018	41,913.87 €	Msh	2018	
<b>Akumulimi</b>		<b>542,722.21 €</b>			
<b>Punimet e Kontraktuara dhe te realizuara ne “%” sipas pagesave deri me 26.12.2018:</b>		<b>45.3 %</b>			

Vrejtje: Sipas faturimeve ne MSH dhe KK Gjilan. Per situacionin 11, MSH nuk ka informata të sakta nga KK Gjilan, është i përafërt!

**Meremetimi i Dializës në SR Mitrovicë, MONITORIMI sipas vendimit nr. 05-8050, dt. 03.11.2017:**

Projekti menaxhohet nga SP Mitrovicë, financohet nga MSH (100%), shuma e kontratës 153,964.13 €. Projekti është dashur te përfundoj në Dhjetor 2017. Projekti akoma nuk është finalizuar, ka devijime nga projekti bazik, me një aprovim të një anshëm nga menaxhmenti në SP Mitrovicë, në kundërshtim me MM.

**Pagesat e realizuara:**

<b>Shuma e Kontraktuar:</b>	153,964.13 €		
Paradhënje - avansi	Pagesa e avansit (15%):	23,094.62 €	2017
Situacioni 1		19,888.43 €	2017
Situacioni 2		75,000.00 €	2017
Total të Paguara deri me 29.06.2018:		117,983.05 €	
Ri-inbursim nga situacioni 1:		2,983.27 €	
<b>Total të paguara deri me 31.12.2017</b>		<b>114,999.78 €</b>	
<b>Nuk ka pasur as një pagesë në vitin 2018 :</b>			
Teknikisht, punimet janë deklaruar të përfunduara 100%, mbetet që kjo të verifikohet nga komisioni			

Vlerësim: Bazuar në pagesat dhe raportimet nga Menaxheri i projektit, monitoruar si proces, konform Marrëveshjes së mirëkuptimit.

**Ndërtimi i Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj:**

Shuma e kontratës: 10,235,587.10 €. KK Ferizaj, ka pajisur MSH me leje ndërtimi për objektin e spitalit, proces ky që është vonuar për rreth 5 muaj kalendarik. Është realizuar dislokimi i tensionit të lartë në Qershor 2018. Deri me 24.12.2018, janë shfrytëzuar 1,717,383.55 €, të mjeteve të parashikuara. Shkalla e realizimit: 12.1% (sipas shkallës së pagesave – situacioneve – pa llogarit avansin). Për shkak të vonësive në dinamikë, si pasojë e ndërrimit të lokacionit dhe paisjes me leje ndërtimi, për shkak të rritjes së nivelit të lagështisë në terren (tetor 2018), është aprovuar ndryshimi i hidroizolimit nga Kondor në Eurobent (toleruar në prezencë të lagështisë – për ta vendosuar në vend), proces ky i përfillur ligjërisht nga Komisioni Menaxhues, por i pa formalizuar nga DI (pa ndonjë arsye). Punimet vazhdojnë pa pengesa.

**Pagesat e realizuara:**

<b>Akumulimi</b>		23,155.42 €	Total te paguara Shtesë,
<b>Shuma e Kontraktuar:</b>	10,235,587.10 €		
Paradhënje - avansi	Pagesa e Avansit (15%):	500,000.00 €	2018
Situacioni 1	Punimet pergaditore, konform Pelqimit formal nga KK Ferizaj,	200,639.31 €	2018
Situacioni 2	11.10.2018	183,580.13 €	2018
Situacioni 3	09.11.2018	366,703.166 €	2018
Situacioni 4	21.11.2018	194,467.076 €	2018
Situacioni 5	14.12.2018	271,993.87 €	2018
<b>Total të paguara deri me 26.12.2018 (përfshi avansin):</b>		1,717,383.55 €	2018
<b>Punimet e Kontraktuara dhe të realizuara në “%” sipas pagesave deri me 26.12.2018:</b>		12.1 % (Pa avans)	

**Punimet shtese:**

<b>Punimet:</b>	<b>Data e kalimit nga DI,</b>	<b>Shuma e paguar (€)</b>	<b>Pagesa e realizuar (viti)</b>
Dislokimi i linjës energjetike egzistuese		23,155.42 €	2018

Rikapitullimi i pagesave deri me 30/09/2018 – Avansi + Punimet:

<b>Punimet e Kontraktuara:</b>		1,717,383.55 €
<b>Punimet shtesë:</b>		23,155.42 €
<b>Akumulimi</b>	1,717,383.55 €	Total i pagesave deri me: 26.12.2018

#### **Ndërrimi i dyerve të sallave të Emergjencës dhe renovimi i Pritores së Emergjencës në QKUK:**

Projekti menaxhohet nga MSh, deri sa mbikqyret nga SHSKUK

Projekti financohet nga MSh

Shuma e kontratës: **114,216.75 €**

Projekti ka filluar në Maj 2018, dhe ka përfunduar me 18.12.2018, përfshi 3.1% punime shtesë.

Projekti është përfunduar me sukses

Janë realizuar rreth 99.5% të punimeve - i kompletuar



Kontrata bazë:

<b>Shuma e Kontraktuar:</b>	114,216.75 €	
Situacioni 1	20.07.2018	33,934.50 €
Situacioni 2		51,438.90 €
Situacioni 3	18.12.2018	28,307.30 €
<b>Total të paguara deri me 26.12.2018:</b>	113,681.70 €	
<b>Deri me 26.12.2018:</b>	<b>Rreth 99.5 %</b>	
<b>Mbetja Financiare:</b>	<b>535.05 €</b>	

Aneks kontrata - Punimet shitesë

<b>Shuma e Kontraktuar:</b>	3,308.00 €	
Situacioni 1	18.07.2018	3,308.00 €
<b>Total te paguara deri me 24.12.2018:</b>	3,308.00 €	
<b>Vlersim Teknik deri me 22.08.2018:</b>	<b>Rreth 100 %</b>	
<b>Mbetja Financiare:</b>	<b>0.00 €</b>	

**RIKAPITULLIMI:**

Kontrata Baza - 113,681.7 €

Anexi Shtese - 3308.0 €

**Total kostoja e projektit: 116,989.7 € (kompletuar dhe perfunduar).**

**Adaptimi i hapësirave për Angiografi ne QKUK**

Shuma e kontratës: 272,272.72 €, projekti ka perfunduar me sukses.

Pagesa e realizuara:

<b>Shuma e Kontraktuar:</b>	272,272.72 €	
Avansi		40,840.90 €
Situacioni 1	22.06.2018	34,122.83 €
Situacioni 2	04.07.2018	55,842.99 €
Situacioni 3	07.09.2018	55,807.60 €
Situacioni 4	06.11.2018	44,058.37 €
Situacioni 5	18.12.2018	41,112.52 €
<b>Total te paguara deri me 26.12.2018:</b>	<b>271,758.21 €</b>	
<b>Vlerësim financiar deri me 26.12.2018:</b>	<b>Rreth 99.8 %</b>	
<b>I KOMPLETUAR.</b>		

Teprica: 487.52 €

**Punimet shtese:**

Shuma e Aneks - Kontrates	26,473.06 €		
Situacioni 1	29.11.2018	19,413.82 €	2018
Situacioni 2	24.12.2018	7,059.24 €	2018
Total te paguara deri me 26.12.2018		26,473.06 €	Total te paguara Shtese:

**Rikaptitullimi i pagesave deri me 26/12/2018 - Punimet:**

Punimet e Kontraktuara:	271,758.21 €	
Punimet shtese:	26,473.06 €	
Akumulimi	298,231.27 €	Total i pagesave deri me: 26.12.2018

**KPSH**

15733 – Renovimi dhe revitalizimi i objektit të Kirurgjisë SP Gjakovë -Ministria e Shëndetësisë dhe Operatori Ekonomik N.N.P. "CONSTRUMAX" me datën 04.09.2018 kanë nënshkruar kontratën. Vlera e kontratës është 370,370.00 €. Për këtë vit janë ndarë 250,000 €. Është realizuar avansi për operatorin ekonomik bazuar në Ligjin për buxhet 05/L071 në vlerë prej 55.555.50 euro. Është realizuar situacioni i pare në vlerë prej 71,752.07€.

15731 – Ndërtimi i aneksit të urgjencës dhe renovimi i QKMF Deçan - kontrata për këtë projekt është nënshkruar nga MSh dhe Operatori Ekonomik "HARTSGRUP" ShPK me datën 03.09.2018. Projekt i paraparë për vitin 2018 me vlerë prej 150,000 € e cila pritet të realizohet gjatë vitit 2018. Është inicuar kërkesa për realizim të avansit për operatorin ekonomik bazuar në Ligjin për buxhet 05/L071 në vlerë prej 44.248.38 €.

14544 - Ndërtimi i ndërtesës së QKMF në Gjiilan - kontrata është nënshkruar me dt. 03/11/2016 në vlerë prej 1,195,438.67 €, ku MSh-së mbulon 1,090,939.40 € ndërsa pjesa tjetër mjetet janë ndarë nga Komuna Gjiilan. Në vitin 2017-2018 janë realizuar 39.04% e punimeve.

15097 - Ndërtimi i ndërtesës së QKMF në Gjakovë - kanë vazhduar punimet. Kontrata është nënshkruar me datë 01/08/2017 në vlerë 802,174.10 €. Është realizuar situacioni i IV në vlerë prej 85,020.30 €.

## 5. Perspektiva për vitin ardhshëm

- Vazhdimi i mbështetjes së zyrtarëve përgjegjës për hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit
- Vazhdimi i procesit të hartimit të UPK-ve.
- Hartimi i raportit vjetor të monitorimit dhe vlerësimit të SSSH për vitin 2017 dhe raporti për monitorim dhe vlerësim për vitin 2018.
- Hartimi i raportit të ndërmjetëm për zbatim të SSSH-së.
- Hapja e thirrjes publike për mbështetje financiare të OIQ-ve bazuar në rregulloren 04/2017. Funkcionalizimi i aplikacionit online për licencimin e IPSh-ve.
- Vazhdimi i zbatimit të planprogramit për infermierët e KPSh, lidhur me ngritjen e shkathtësive klinike dhe procedurave /ndërrhyrjeve infermiore, sipas kërkesave të institucioneve të KPSh. Angazhimi aktiv në grupet punuese të përcaktuara nga instancat ma të larta në MSH-së. Sistemimi i kandidatëve në KPSh apo KDI dhe dhënia e instruksioneve dhe udhëzuesëve për kryerje të stazhit obligativ.
- Vazhdimi i furnizimit të qëndrueshëm për Ish bazuar në nevojat e paraqitura.
- Fuqizimi i kujdesit parësor shëndetësor, duke përmirësuar qasjen në shërbimet shëndetësore, përfshirë edhe vendet më të largëta rurale. Hartimi i politikave dhe standardeve për nivelin e kujdesit parësor shëndetësor.
- Koordinimi në zbatimin e agjendës evropiane 2019, në zbatimin e konkluzioneve në kuadër të takimeve për nën komitetet e MSA me komisionin e evropian 2019
- Koordinimi në zbatimin e programit kombëtar për MSA 2019 në zbatimin e PVPQ 2019, koordinimi i politikave në Ministrinë e Shëndetësisë, koordinimi i aktiviteteve për asistencë teknike për projektet në vazhdimësi.
- Realizimi i Programit legjislativ qeveritar për vitin 2019 dhe realizimi i Planit legjislativ për aktet nënligjore për vitin 2019.
- Fuqizimi i kapaciteteve brenda pozitive në Departament ligjor përkatësisht plotësimin e pozitive të lira.
- Në vazhdimësi regjistrimi i lëndëve të kontesteve gjyqësore në modulën elektronik sipas të dhënave që posedon Departamenti.
- Finalizimi dhe zbatimi i Planit të Komunikimit (2019-2021)
- Përmirësimi i komunikimit të brendshëm, ndërinstitutional dhe me publikun
- Fuqizimi i kapaciteteve të Divizionit të Komunikimit me Publikun
- Mbështetja për Zyrën e SP dhe departamentet e Ministrisë
- Hartimi i Planit Kosovar për Kontroll të Duhanit
- Mbajtja e trajnimeve për profesionistët shëndetësor për Ligjin për Barazi gjinore dhe ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, PSV dhe Udhërrefyesin e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore.

## 6. Sfidat

- Vonesa në finalizimin e dokumenteve strategjike
- Realizimi i aktiviteteve kryesore në kuadër të PVPQ 2019
- Realizimi i aktiviteteve kryesore në kuadër të PKZMSA 2019
- Koordinimi i asistencës teknike
- Të gjeturat e raportit të BE për Kosovën 2019
- Mungesa e stafit profesional në Divizionin për Kujdes Parësor Shëndetësor
- Realizimi i Programit dhe Planit legjislativ dhe finalizimi e akteve ligjore dhe nënligjore nga zyrtarët përgjegjës sipas vendimit të ZSP si dhe aprovimi paraprak nga Ministri i Shëndetësisë të Projekt akteve ligjore dhe nënligjore.
- Bashkëpunimi jo efikas i institucioneve/departamenteve në kuadër të Msh-së për sigurimin e provave dhe shkresave të lëndës sipas afateve të përcaktuara nga Avokatura shtetërore për lëndët e kontesteve gjyqësore
- Gjatë vitit 2018 janë hasur vështirësi në mirëmbajtjen e veturave dhe mungesa e kontratës për furnizim me toner, për telefona fikse dhe pajisje me kamera për objektin e MSh-së.
- Kapacitetet e kufizuara të Divizionit me resurse humane
- Mungesa e përkrahjes në kuadër të projekteve mbështetëse të MSh për DKP
- Rritja e kërkesave për qasje në dokumente publike
- Mos finalizimi i dokumenteve dhe UA nga viti paraprak dhe mbetja e tyre ende në procedura pa vendimarrje finale
- Resurset e kufizuara teknike në DKP.